Trualli I stadiumit te lojrave me dore	m2	4,230	14,034	59,363,000		
Trualli I magazines 2 kate lagja 1 Maji	m2	700	9,338	6,536,600		6,536,600
shuma e truallit				**289,115,152**	**0**	**289,115,152**
Ndertime stadiumi Loni Papuciu	cope	1	57,720,765	57,720,765	1,924,026	55,796,740
Bodrumi bilardo m2 610	cope	1	24,412,200	24,412,200	813,740	23,598,460
Ndertesa e stadiumit te lojrave me dore	cope	1	24,398,860	24,398,860	813,295	23,585,565
Magazina 2 kate lagja 1 Maji	cope	1	37,688,467	37,688,467	1,256,239	36,432,228
shuma e ndertesave				**144,220,292**	**4,807,300**	**139,412,992**
Kompjutera	cope	2	49,920	99,840		99,840
				433,435,284	**4,807,300**	**428,627,984**

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(te Ushtrimit te mbyllur me date 31.12. 2018)

08 Shkurt 2019

"Klubi Shumesportesh Apollonia" Sh.a. eshte Shoqeri aksionere, themeluar dt 31.03.2018 me aksioner te vetem Bashkine Fier, rregjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier me nipt L82816405H. Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen: Lagjja Liri, Rruga Feride Bega, Ndertesa nr. 9, Hyrja 1, Fier.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "Klubi Shumesportesh Apollonia" sha eshte: "Perfaqesimi dhe pjesmarrja ne te gjithe veprimtarine sportive kombetare dhe nderkombetare me te gjitha disiplinat sportive te njohura nga Komiteti Olimpik Kombetar Shqipetar(KOSKH), Komiteti Olimpik Nderkometare,(IOC) dhe te gjitha Federatat Shqipetare Sportive te njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ligjin nr 79/2017, "Per Sportin". Vazhdimi i tradites sportive, zhvillimin dhe rritjen e cilesis sportive ne te gjitha sportet qe ushtrohen dhe perfaqesojne Bashkine Fier. Krijimin e ekipeve zinxhire te grupmoshave te ndryshme ne sportet e lojrave me dore dhe sportet e renda si basketboll, volejboll, ciklizem, boksi, peshengritja etj. Krijimin e lidhjeve miqesore, shkembimeve te eksperiencave me klubet sportive, shoqatat sportive dhe shoqerite brenda dhe jashte vendit. Manaxhimin, administrimin dhe mirembajtjen e objekteve sportive qe jane ne pronesi te shoqerise Klubi Shumesportesh Apolonia sha. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet ne menyre te drejtperdrejt apo te terthorte me objektin e saj. Shqoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me lejet, autorizimet, licensat sipas legjislacionit ne fuqi".

Shoqeria "Klubi Shumesportesh Apollonia" shpk ***administrohet*** nga administratori i shoqerise z. Palion Zarka, i cili ka kompetenca per drejtimin e saj mbi bazen e statutit.

Gjendjet financiare jane shprehur ne leke. Çdo veprim eshte mbeshtetur ne dokumenta justifikues dhe dokumenta kontabel te cilat jane ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne kontabilitet jane rregjistruar te gjitha transaksionet financiare qe i takojne periudhes ushtrimore 2018, dhe qe ndikojne ne rezultatin e ketij ushtrimi. Veprimet jane ngurtesuar me 31 dhjetor 2018.

Aktivet afatgjata materiale paraqiten ne bilanc me koston e blerjes (per ndertesat dhe truallin me vleren e caktuar te eksperteve vleresues per futjen e tyre si kontribut ne kapitalin e shoqerise) minus amortizimin e akumuluar.
Amortizimi eshte llogaritur ne baze grupimi per aktivet afatgjata materiale sipas Ligjit Nr. 8438, dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat".
Stoku eshte vleresuar me koston e marrjes.
Shpenzimet jane kontabilizuar ne baze te dokumentave justifikuese.
Te ardhurat jane kontabilizuar ne baze te faturave tatimore.
Parimi baze per percaktimin e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte parimi i te drejtave te konstatuara.

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 856.144 leke paraqesin mjete monetare ne Banke.
Shoqeria operon me FI banke ne leke, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditarin perkates, gjendja e saj perputhet me posten e bankes se dates 31.12.2018.

Ne llogarine ***Lende te para dhe materiale te tjera*** per 519.448 leke, shoqeria ka paraqitur gjendjen e inventarit te imet ne date 31.12.2018, gjendje ne magazine dhe ne perdorim. Per inventarin ne perdorim eshte llogaritur konsumi i tij ne masen 50%.

Aktive afatgjata materiale
Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata per 428.627.984 leke.
Aktivet jane krijuar nga futja si kontribut ne kapitalin e shoqerise te truallit dhe ndertesave si vijon:
1.Stadiumi i futbollit "Loni Papuçiu"
- Truall 18.592 m^2 ne vlere 223.215.552 leke
- Ndertime ne vlere 57.720.765 leke

2.Bodrum (bilardo) sipefaqe ne m^2 610 ne vlere 24.412.200 leke.
3.Stadiumi i lojrave me dore
- Truall me siperfaqe 4230m^2 ne vlere 59.363.000 leke.
- Ndertese ne vlere 24.398.860 leke

4. Magazine 2 kate lagja"1 Maji"
- Truall ne m^2 700 ne vlere 6.536.600 leke dhe,
- Ndertese ne vlere 37.688.467 leke

Gjate vitit 2018 jane blere nga shoqeria kompjutera ne vlere 99.840 leke.
Eshte llogaritur amortizim vetem per ndertesat me normen 5% per muajt pas muajit te krijimit. Amortizimi shkon ne vleren 4.807.300 leke, llogaritur sipas ligjit per tatimin mbi te ardhurat.

Aam jusfikohen me inventar fizik te kryer ne fund te ushtrimit.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlere 428.291.726 leke.
Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 433.335.444 leke te cilat i takojne aksionerit te vetem Bashkise Fier.

Humbje ushtrimit sipas bilancit kontabel paraqitet per 5.043.718 leke.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet me vlere 1.711.850 leke perfaqesojne:

	Viti 2018
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	80.365
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	1.561.807
Detyrime tatimore	68.678
Hua te tjera	1.000
Totali	**1.711.850**

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 80.365 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimin e shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 582.658 leke, pagat e keshillit mbikqyres 48.076 leke, pagat per trajneret me kontrate ne shumen 175.100 leke, pagat per sportistet me kontrate ne shumen 563.700 leke si edhe sigurimet shoqeroreper muajin dhjetor 2018 ne shumen 192.273 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- ***Tatimi mbi te ardhurat*** pagat e punonjesve ne shumen 29.294 leke, detyrim per muajin dhjetor 2018 si edhe,
- ***Tatim ne burim*** per punonjesit me kontrate trajnere dhe anetaret e keshillit te administrimit ne shumen 39.384.

Hua te tjera ne shumen 1.000 leke, paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

Verifikimi i llogarise Fitim Humbje

Shpenzimet dhe te ardhurat jane grupuar si me poshte:

	Viti 2018
Te ardhura	
Nga sponsorizimet	15.500.000
Totali (Afarizmi)	**15.500.000**
Shpenzime te veprimtarise	
Materiale te konsumuara	424.716
Kosto e punes	7.191.790
Pagat e personelit	6.127.663
Shpenzimet per sigurime	1.023.327
Shpenzime te tjera per personelin	40.800
Amortizimi	4.807.300
Shpenzime te tjera	8.119.912
Totali i shpenzimeve	**20.543.718**
Fitim/Humbje bruto	**(5.043.718)**
Humbje (bilanci)	**(5.043.718)**

Fitim/Humbje bruto	**(5.043.718)**
Humbje (bilanci)	**(5.043.718)**

Shpenzimet jane 20.543.718 leke ndersa te ardhurat 15.500.000 leke. Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte humbje ne shumen 5.043.718 leke.
Te ardhurat pasqyrojne te ardhura nga sponsorizime nga Bashkia Fier ne shumen 15.500.000 leke.

Shpenzimet ne shumen 20.543.718 leke justifikohen me dokumenta te rregullta fiskale. Me konkretisht shpenzimet sipas zerave paraqiten:

Shpenzime per mallra 424.716 leke, jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise, keto shpenzime jane te justifikuara me dokumenta.

Personeli, ne kete llogari jane pasqyruar shpenzimet per paga 6.127.663 leke, sigurime shoqerore 1.023.327 leke si edhe shpenzime te tjera per personelin shperblim per pension ne shumen 40.800 leke, listepagesat jane perpiluar sakte dhe shpenzimet per paga e sigurime jane vendosur korrekt ne kete llogari.

Amortizimi me vlere 4.807.300 leke eshte llogaritur ne baze grupimi, shuma e tij nuk kalon kufijte e fiskut.

Shpenzime te tjera per 8.119.912 leke paraqesin:

- Shpenzime per uje ne shumen 71.520 leke,
- Shpenzime per konsumin e inventarit te imet ne shumen 475.812 leke,
- Punonjes te jashtem ne shumen 4.824.490 leke, ketu jane perfshire pagat e trajnereve, sportisteve dhe keshillit te administrimit.
- Shpenzime per fjetje ne hotel te sportisteve ne shumen 129.500 leke,
- Shpenzime per internet ne shumen 31.990 leke,
- Shpenzime transporti per sportistet ne shumen 336.000 leke,
- Shpenzime komisjone banke per 17.900 leke,
- Shpenzime per rregjistrimin ne federatat ne shumen 529.000 leke,
- Shpenzime sponsorizimi ne shumen 1.606.500 leke,
- Shpenzime te tjera per 97.200 leke, shpenzime dreke per fundvitin .

Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte humbje ne shumen 5.043.718 leke

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

MARTIN DODI
KRYETAR

PALION ZARKA
ANËTAR

NEVILA ÇALA
ANËTAR

Konceptoi: Idai Qorraj